



Agjencia e Akreditimit e Kosovës  
Kosovo Accreditation Agency  
Agencija za Akreditovanje Kosova

Qendra e Studentëve, kati i II-të  
10000 Prishtinë, Kosovë

Tel : +381 38 213-722

Fax:: +381 38 213-990

e-mail: [kaaoffice@gmail.com](mailto:kaaoffice@gmail.com)

web: [www.akreditimi-ks.org](http://www.akreditimi-ks.org)

Nr. 512/13 dt. 08.07.2013

Në mbështetje të nenit 145 (pika 2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke marrë parasysh nenet 4, 21, 22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr. 03/L-189), Ligji për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 04/L-037), neni 7 (pika 2.3 dhe pika 4), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e BPrAL (nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e AKA-së (nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (nr. 02/2013), në Udhëzimin Administrativ për Kriteret dhe Procedurën e Akreditimit të Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (nr. 12/2009), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë i Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka shqyrtuar raportet e ekspertëve të vlerësimit dhe në bazë të rekomandimeve, në mbledhjen e mbajtur më 3 Korrik 2013, mori:

## V E N D I M

I. Riakreditohet Kolegji “Universum” në nivel institucional për një periudhë prej 5 viteve (1 Tetor 2013 – 30 Shtator 2018).

II. Programet e studimit:

- Shkenca Kompjuterike (BSc) R (Prishtinë)
- Biznes dhe Menaxhment (BA) – (me specializimet në: Menaxhment; Banka dhe Financa; Biznesi Ndërkombëtar; Marketing dhe Komunikim) R (Prishtinë, Ferizaj)
- Menaxhment (MA) – (me specializimet në: Menaxhment; Biznesi Ndërkombëtar; Financa) R (Prishtinë)
- Administrim Publik, Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Evropiane (BA) R (Prishtinë, Ferizaj)

akreditohen për një periudhë 3 vjeçare (1 Tetor 2013- 30 Shtator 2016).

III. Programet e studimit:

- Gjuhë dhe Letërsi Angleze (BA) A
- Manaxhimi i Sistemeve Informativë (BA) A
- Qeverisje (MA) A

nuk akreditohen.

IV. Riakreditohet dega në Ferizaj.

V. Institucioni i juaj është i obliguar që të hartojë një Plan të Përmirësimit në bazë të rekomandimeve të dhëna nga Ekipi i Ekspertëve (në të dy gjuhët dhe në të dy versionet) dhe të njëjtin ta dorëzoni në Agjencinë e Kosovës për Akreditim gjer më 1 Dhjetor 2013.

VI. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Ferdije Zhushi Etëmi, kryetare  
Këshilli Shtetëror i Cilësisë